



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 25.06.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“OSOJA HPP” SH.P.K, PËR LICENCIM E NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “OSOJE” ME FUQI TE INSTALUAR 1922 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; dhe nenit 10 pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSOJA HPP” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “OSOJE”, me fuqi të instaluar 1922 KW,

**Konstatoi se:**

Shoqëria “OSOJA HPP” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “OSOJE”, me fuqi të instaluar 1922 KW, protokolluar në ERE me nr. 430 Prot., datë 05.06.2018.

Aplikimi i shoqërisë “OSOJA HPP” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; 4.1.5 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Dhënien e miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të transferimit të të gjitha të drejtave, kontratat dhe licencat në lidhje me këtë objekt, nga ortakët “Favina” sh.p.k; “Favina 1” sh.p.k dhe “Osoja Energy” sh.p.k., tek shoqëria “Osoja HPP“ sh.p.k., do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’ a paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë “OSOJA HPP“ sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “OSOJE” me fuqi të instaluar 1922 kW
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.